REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 752 prot Tiranë, më 11/11/2026

VENDIM
Nr. 11 datë 11.11.2026

PËR
MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE VENDORE TË DATËS 9/11/2026

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 244, datë 17.04.2024 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 9.11.2026 vendosi:

1. **Për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2024, "Për sigurinë kibernetike" dhe projektvendimi për propozimin e ligjit për "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2024, "Për sigurinë kibernetike",** propozuar nga Auroriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (Kryeministria), bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektligjin.

2. **Për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën" i ndryshuar,** propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektligjin.

3. **Për projektvendimin "Për menaxhimin e mbetjeve minerare",** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Referuat nenit 7. Kërkesa për miratimin e planit të menaxhimit të mbetjeve minerare duhet të shoqërohet detyrimisht me pëlqimin paraprak të Këshillit Bashkiak të njësisë ku do të zhvillohet aktiviteti.

Referuat nenit 8, ku trajtohet leja e kategorisë IV.1, të shtohet si kriter detyrues vërtetimi nga bashkia përkatëse që lokacioni i propozuar për venddepozitimin është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor.

Referuat nenit 14. Ministri miraton mbylljen e objektit pasi struktura përgjegjëse konstaton përmbushjen e kushteve. Propozohet që certifikimi i rikthimit të territorit në një gjendje të përshtatshme për përdorim të mëtejshëm të shqyrtohet dhe nga bashkitë pritëse.

Referuat nenit 24. Gjatë inspektimeve periodike çdo 6 muaj nga struktura përgjegjëse, të parashikohet me ligj pjesëmarrja e përfaqësuesve të inspektoratit vendor të mjedisit.

Referuat nenit 25. Projektligji detyron operatorin të paraqesë raport 6 mujor mbi stabilitetin dhe cilësinë e ujërave vetëm pranë strukturës përgjegjëse qendrore. Propozohet që pika 1 e këtij neni të ndryshohet duke saktësuar se raporti i dërgohet njëkohësisht për dijeni dhe monitorim edhe bashkisë përkatëse.

Referuat nenit 26. Për kundërvajtjet administrative që variojnë nga 50,000 deri në 2,000,000 lekë, të shtohet një pikë ku përcaktohet se 50% e vlerësë së gjobës së arkëtuar të transferohet në buxhetin e bashkisë ku ka ndodhur shkelja, si kompensim për dëmin mjedisor të shkaktuar në territorin lokal.

4. **Për projektvendimin "Për miratimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte",** propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Referuar neneit 1, 8, 9 dhe 13; Aneksi III; relacioni, faqja 14.

Neni 1 deklaron se venddepozitimet nuk klasifikohen si landfille. Njëkohësisht:

a) Afati i funksionimit mund të arrijë pesë vjet.
b) Deri në 55% e mbetjeve destinohet për depozitim.
c) Parashikohet mbulim dhe rehabilitim në vend.
d) Relacioni pranon se një pjesë e mbetjeve mbetet aty pas mbylljes.

Kjo krijon një çështje thelbësore: përkohshmëria e pranimit të mbetjeve nuk provon përkohshmërinë e depozitimit të tyre.

Rekomandohet të zgjidhet qartë modeli:

a) Nëse kemi magazinim të përkohshëm, të përcaktohen destinacioni pasues, afati i largimit, përgjegjësi dhe financimi.
b) Nëse mbetjet mbeten përfundimisht në vend, të zbatohet klasifikimi dhe regjimi ligjor që përputhet me funksionin real të objektit.

Një përjashtim i përgjithshëm nga klasifikimi si landfill nuk duhet të mbështetet vetëm në emërtimin e objektit.

Referuar nenit 2, 3 dhe neni i titulluar "Detyrimet e operatorit"; seksioni VIII i relacionit.

Neni 2 parashikon administrim të centralizuar nga shteti. Përkufizimi i operatorit është ndërkohë i hapur për çdo person fizik ose juridik, ndërsa relacioni e paraqet AKEM-në si subjektin kryesor të zhvillimit dhe administrimit.Këto formulime nuk sqarojnë plotësisht nëse lejohet operim i pavarur privat ose bashkiak dhe si lidhet ai me sistemin kombëtar.

Të përcaktohen qartë:

a) Subjektet që mund të aplikojnë dhe operojnë;
b) Marrëdhënia ndërmjet zhvilluesit, mbajtësit të lejeve dhe operatorit;
c) Përgjegjësia kur operimi kryhet nga shoqëri e krijuar nga AKEM-ja;
d) Kushtet e ndryshimit të operatorit dhe vazhdimësia e detyrimeve mjedisore.

Krijimi i shoqërive dhe kontraktimi i shërbimeve duhet të dallohen nga transferimi i përgjegjësive ligjore.

Referuar nenit 2, 7, 12 dhe 14 të projektvendimit ku relacioni deklaron se roli i bashkive ruhet, por procedura e miratimit përqendrohet te AZHT-ja, ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, pa përcaktuar pjesëmarrjen e bashkisë përkatëse

Referuar nenit 4. Të shtohet detyrimi për marrjen e mendimit me shkrim të bashkisë përpara miratimit të vendndodhjes, lidhur me përputhshmërinë me dokumentet e planifikimit territorial, infrastrukturën rrugore vendore, zonat e banuara dhe interesat e komunitetit. Mendimi i bashkisë të bëhet pjesë e dokumentacionit të shqyrtimit dhe të vlerësohet nga autoriteti kompetent, pa u trajtuar si zëvendësim i lejeve apo autorizimeve që lëshohen nga organet përgjegjëse

Referuar nenit 4 dhe 9 Aneksi III.

Pragu minimal 5 000 m² dhe lartësia minimale dy metra nuk shoqërohen në relacion me analizë të mjaftueshme sipas sasive dhe kushteve territoriale. Formula përdor dendësinë "në gjendje depozitimi", krahas një koeficienti që bashkon kompaktimin dhe shfrytëzimin e volumit. Duhet verifikuar shmangia e llogaritjes së dyfishtë të të njëjtit efekt. Rekomandohet argumentimi i pragjeve dhe ndarja e parametrave teknikë, duke parashikuar edhe hapësirat për stokun në pritje të rikuperimit, qarkullimin, kontrollin e ngarkesave dhe kapacitetin rezervë. Përshtatshmëria e vendndodhjes duhet të vlerësohet sipas rrezikut real, përfshirë përmbytjet, stabilitetin dhe mbrojtjen e burimeve ujore.

Reforma me 46 bashki dhe 12 qarqe kërkon plan zbatimi. Reforma duhet të përdoret për të përmirësuar organizimin ndërbashkiak, pa imponuar automatikisht një venddepozitim për çdo bashki.

Rekomandohet një aneks territorial që evidenton:

a) Sasitë e pritshme dhe zonat e mbulimit;

b) Distancat e transportit dhe ndikimin mbi rrugët;
c) Kapacitetet e përbashkëta dhe kostot përkatëse;
d) Transferimin e dosjeve, marrëveshjeve, aseteve dhe detyrimeve te njësitë
e) pasardhëse;
f) Vazhdimësinë e raportimit dhe komunikimit me operatorët gjatë tranzicionit.

Referuar nenit 6 dhe 9; anekset I dhe III.

Neni 6 kërkon që mbetjet e pranuara të mos përmbajnë fraksione të riciklueshme ose të ripërdorshme. Ndërkohë, neni 9 kërkon rikuperimin e të paktën 45% të sasisë së pranuar dhe Aneksi i kërkon pajisje për riciklim. Kjo krijon paqartësi mbi materialin që do të rikuperohet.

Rekomandohet:

a) Të dallohet materiali për rikuperim nga mbetja për depozitim.
b) Të përcaktohen matja sipas peshës, bilanci i hyrjeve, daljeve dhe stokut.
c) Të shmanget numërimi i dyfishtë i materialeve.
d) Të provohet destinacioni dhe përdorimi real i materialit të rikuperuar.
e) Të përcaktohen masat korrigjuese kur kuota nuk realizohet.

Pohimi i relacionit se kuota 45% është "plotësisht në përputhje me acquis" duhet riformuluar dhe argumentuar. Një kuotë operative kalimtare nuk barazohet vetvetiu me përmbushjen e objektivit evropian.

Referuar nenit 7 të plotësohet me:

a) Njoftimin dhe marrjen e mendimit të bashkisë ku propozohet venddepozitimi;
b) Vlerësimin e përputhshmërisë me dokumentet territoriale të zbatueshme;
c) Vlerësimin e aksesit, ndikimit mbi rrugët vendore, vendbanimet dhe shërbimet publike;
d) Konsultimin edhe të bashkive të tjera që mund të preken.;
e) Administrimin e mendimeve në dosje dhe arsyetimin e trajtimit të tyre.

Pjesëmarrja e bashkisë duhet të realizohet brenda kompetencave ligjore dhe nuk duhet ngatërruar me krijimin e një të drejte të përgjithshme vetoje.
Të parashikohet që, gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje, bashkia përkatëse të njoftohet dhe t'i vihet në dispozicion dokumentacioni teknik e hartografik që lidhet me vendndodhjen dhe aksesin në infrastrukturën vendore. Bashkisë t'i lihet një afat i përcaktuar për të paraqitur mendimin e saj, i cili t'i bashkëlidhet dosjes së aplikimit dhe të merret në konsideratë nga autoriteti miratues.

Referuar nenit 7 dhe neni "Detyrimet e operatorit".

Projektvendimi përshkruan procedurën e lejes së ndërtimit dhe përdor formulimin "mbi bazën e vetëdeklarimit", por nuk e bën mjaftueshëm të qartë tërësinë e kushteve për fillimin e operimit. Rekomandohet të përcaktohet se pranimi dhe trajtimi i mbetjeve fillojnë pas përmbushjes së të gjitha lejeve, licencave dhe procedurave mjedisore të kërkuara, sipas kategorisë së veprimtarisë. Vetëdeklarimi nuk duhet të interpretohet si zëvendësim i tyre. Duhet të identifikohet edhe autoriteti që verifikon kushtet për fillimin e operimit.

Referuar seksionit VIII i relacionit; neni 12 i ligjit nr. 139/2015. Relacioni evidenton sugjerimin për shqyrtim në Këshillin Konsultativ, por përgjigjet kryesisht duke theksuar karakterin kalimtar dhe mungesën e ndryshimit formal të kompetencave. Ky argument nuk është i mjaftueshëm. Konsultimi lidhet edhe me ndikimin e drejtpërdrejtë mbi ushtrimin e funksioneve vendore, jo vetëm me transferimin formal të tyre.Rekomandohet dokumentimi i konsultimit me njësitë vendore dhe shoqatat përfaqësuese, përmes mekanizmave përkatës, duke paraqitur komentet dhe mënyrën e trajtimit. Mendimi i ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisjen vendore nuk e zëvendëson vetvetiu konsultimin me njësitë vendore.

Referuar nenit të parë me numrin 10, "Tarifat e pranimit".

Pika 1 parashikon miratim nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Pika 2 parashikon regjim tjetër kur operator është AKEM-ja ose shoqëria e krijuar prej saj, duke ju referuar legjislacionit tregtar dhe statutit.Mbetet e paqartë natyra e pagesës, organi miratues dhe marrëdhënia ndërmjet dy regjimeve.

Rekomandohet:

a) Të dallohet tarifa vendore nga tarifa e pranimit në impiant ose çmimi i shërbimit;
b) Kur është kompetencë vendore, të identifikohet organi përkatës, duke respektuar nenin 54, shkronja "f", të ligjit nr. 139/2015;
c) Për tarifimin nga AKEM-ja të jepet baza e posaçme ligjore dhe procedura e miratimit;
d) Të përcaktohen kostot e përfshira, publikimi, rishikimi dhe shmangia e faturimit të dyfishtë.

Gjithashtu, detyrimi i përgjithshëm për dorëzim në venddepozitim duhet të harmonizohet me mundësinë e dërgimit të ligjshëm në impiante rikuperimi ose trajtimi, në respektim të hierarkisë së mbetjeve.

Referuar nenit 10. Të përcaktohet në mënyrë të qartë se cila njësi e vetëqeverisjes vendore është kompetente për miratimin e tarifës (bashkia ku ndodhet venddepozitimi apo njësi të tjera të përcaktuara), cili organ vendor e miraton atë dhe cila është procedura përkatëse. Gjithashtu, të sqarohet baza ligjore dhe natyra juridike e tarifës së pranimit. Të hartohet një metodologji e unifikuar dhe transparente për përllogaritjen, miratimin dhe rishikimin e tarifave, e cila të përcaktojë elementet e kostos, dokumentacionin justifikues, mënyrën e verifikimit dhe publikimin e tarifave. Të sqarohet gjithashtu mekanizmi i transparencës dhe kontrollit për tarifat e vendosura nga AKEM sh.a. ose shoqëritë e krijuara prej saj, duke shmangur trajtimin e pabarabartë të operatorëve

Referuar nenit 12, pika 6. të shtohet një pikë për identifikimin e strukturës përgjegjëse me funksione inspektimi, si dhe përgjegjësinë e organit inspektues ,(struktura përgjegjëse qendrore inspektuese për mjedisin, ujëra, pyjet dhe territorin/IKMT) , për garantimin e zbatimit të këtij vendimi, nëpërmjet ushtrimit të kontrollit dhe inspektimit, në zbatim të ligjit për inspektimin, dhe ligjeve sektoriale për fushën e mjedisit, ujërave dhe zhvillimin e kontrolluar të territorit.

Referuar nenit 13, pikat 5-8.

Vendosja paraprake e garancisë financiare është pozitive. Megjithatë, AKEM-ja përjashtohet me arsyetimin se i nënshtrohet ligjit nr. 57/2025, pa identifikuar në dispozitë mekanizmin konkret që siguron fondet në vend të garancisë.Rekomandohet rishqyrtimi i përjashtimit dhe evidentimi i bazës ligjore. Nëse ruhet, të parashikohet një mekanizëm i barasvlershëm, i verifikueshëm dhe i disponueshëm për mbylljen, rehabilitimin dhe monitorimin pas mbylljes.Për garancinë duhen saktësuar përfituesi juridik, metodologjia e vlerës, afati, përditësimi, ekzekutimi dhe lirimi i saj.Bashkia nuk duhet të bëhet përgjegjëse automatike për rehabilitimin për shkak të vendndodhjes së objektit ose mungesës së fondeve të operatori.

Referuar nenit 13. Të sqarohet se cili instrument financiar ose mekanizëm tjetër ligjor garanton përmbushjen e detyrimeve të mbylljes dhe rehabilitimit kur operator është AKEM sh.a. Gjithashtu, të parashikohet informimi i bashkisë për përfundimin e procesit të rehabilitimit dhe për aktin e konstatimit të përmbushjes së detyrimeve, kur objekti ndodhet në territorin e saj.

Referuar nenit 14, pika 2. Të plotësohet dispozita duke parashikuar bashkëpunimin dhe informimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, vetëm brenda kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, pa u ngarkuar me detyra të reja operacionale apo financiare që nuk parashikohen shprehimisht në ligj Sipas neneve 14 dhe 31 të ligjit nr. 139/2015, bashkëpunimi ndërbashkiak dhe harmonizimi rajonal mund të mbështesin zbatimin. Qarqeve nuk u lind automatikisht kompetencë operimi ose miratimi tarifash. Zonat funksionale të menaxhimit të mbetjeve nuk duhen barazuar pa analizë me kufijtë e bashkive ose qarqeve.

Neni 14. Pika 2. Të riformulohet si vijon: Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), struktura pergjegjese qendrore inspektuese per mjedisin, ujera, pyjet dhe territorin/IKMT, dhe operatorët

Referuar relacionit i cili përmend mendimin e dhënë nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe, në fund, e përcjell variantin për bashkërendim edhe te Ministria e Punëve të Brendshme.

Për rrjedhojë, nuk rekomandohet zëvendësimi mekanik i çdo reference historike. Duhet:

a) Të ruhen emërtimet historike kur përshkruajnë korrespondencë të asaj kohe, me datën përkatëse.
b) Të përdoret institucioni aktual për veprimet e reja dhe përgjegjësitë në vijim.
c) Të sqarohet roli mbështetës i AMVV-së sipas mandatit të saj.

Referuar korrigjime të domosdoshme të tekstit rekomandohen;

a) Numërtimi: dy dispozita mbajnë numrin 10. Pas korrigjimit të kontrollohen të gjitha referencat.
b) Relacioni: përmbledhja e neneve të përshtatet me variantin përfundimtar të projektvendimit.
c) Kronologjia: data "27 korrik 2027" të verifikohet kundrejt shkresës origjinale, pasi nuk përputhet me kronologjinë e procesit të përshkruar.
d) Shfuqizimet: neni 14 të identifikojë shprehimisht dispozitat e VKM-së nr. 575/2015 që shfuqizohen dhe ato që ruhen.

e) Monitorimi: neni 12 të parashikojë marrjen e informacionit edhe nga bashkitë e prekura dhe njoftimin për incidente.
f) Zbatimi: lista e institucioneve në nenin 14 të harmonizohet me detyrat e shpërndara në tekst.
g) Terminologjia: të unifikohen "venddepozitim", "landfill", "magazinim", "rikuperim" dhe "depozitim maksimal".
h) Anekset: të saktësohen referencat teknike, standardet e pranimit dhe parametrat e monitorimit.

Të sqarohet nëse bashkia Tiranë, meqenëse është në proces prokurimi për realizimin e një studimi lidhur me mundësinë e zhvillimit të një venddepozitimi për mbetjet inerte, mund të jetë iniciatore dhe/ose investitore për studimin dhe zhvillimin e një infrastrukture të përhershme ose te përkoheshme për mbetjet inerte; 2) si duhet të harmonizohet një iniciativë të tillë me planifikimin sipas zonave të menaxhimit të mbetjeve dhe me infrastrukturën rajonale të parashikuar nga ligji nr. 57/2025; 3) cili është roli i AKEM sh.a. në koordinimin, vlerësimin dhe integrimin e një projekti të tillë në planifikimin kombëtar/rajonal.

Sugjerohet përfshirja e bashkive në planifikim, dhënien e lejes dhe monitorim si dhe çdo operator të bashkërendojë plotësisht vendimmarrjen me pushtetin lokal dhe të ofrojë garancitë e barabarta financiare për rikualifikimin e territorit.

5. **Për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile",** propozuar nga Ministria e Mbrojtjes, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektligjin.

Z. Oltjon Muzaka
Zëvendësministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Aldrin Dalipi
Kryetar/Bashkëkryetar
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë